

# **PETKA (GJYPETA) MBI 4000 VJEÇARE E PULTIT TË MADH ILIRO-DALMAT QË FLET SHQIP**

Sokol **SUSAJ**

Etnomuzikolog, Akademia “Rrënjët Tona”

## **PËRMBLEDHJE**

Një nga tipet e veshjes së leshtë të femravë të shqipërisë së veriut është Gjypeta me tri gurra. Fjala gjypetë përbëhet nga fjalët gjyrë dhe petkë, fjalë këto me etimologji indoevropiane që deri në vitet 60 të shek. te kaluar gjendeshin rëndomë në fjalorin e veshjeve të Nikaj-Mërturit territori i së cilët përfshihej në Pultin e madh krahinë. Gjypeta ka formën të njëjtë me atë të Malësisë së madhe por është më e ngushtë dhe ka më shumë simbolika apo shkrim sipas të folurit vendase. Kthimi i tunit të gjypetës nuk është i bardhë me përjashtim të gjypetës së vajzave. Në elementët e petkës gjypetë emërtimet e pjesve të saj janë pothuajse të gjitha në gjuhën shqipe të vjetër si dhe vetë fjala gjypetë. *Fjalë kyçe: gjypeta, doke, rrafsh, ngjeshe, krahol.*

## **ABSTRACT**

One of the types of woolen clothing of women of northern Albania is Gjypeta with three holes. The word gjypetë consists of the words gjyro and petkë, words with Indo-European etymology that until the 60s of the last century were commonly found in the clothing dictionary of Nikaj-Mërtur whose territory was included in the great Pultin province. The vault has the same shape as that of the Great Highlands but is narrower and has more symbolism or writing according to the local dialect. of its parts are almost all in the old Albanian language as well as the word gjypetë itself.

*Key words: dress, mores, flat, belt, vest.*

## **HYRJE**

Etnokultura vendase është e ndikuar nga një klimë rritesh, dokesh e zakonesh të shtratit mitologjik iliro-pagan, nga më të fuqishmit dhe më të larmishmit, që nga kohët më të lashta, tipar i shoqërive të mbyllura gjinore që jetonin në malet e Ballkanit Perëndimor. Imagjini një natë feste në Nikaj-Mërtur, ku nga kullat alpine të bien 800 lahuta përnjëherë, në një luginë midis malesh dinarike që prekin retë. Kur këndon lahuta me tingujt e dheut në emocion, ajo rrafshon malet e, mbi këtë rrafsh, ngrihet madhërishtëmi i malësorës me kultin e amësisë, portretizuar në veshjen mitologjike që kërkon të mposhtë të ligën e të përtërijë jetën. Duke folur me gjuhën e vjetër shqipe të viteve '60, trupi i njeriut vishet me *petka*. Një produkt i tillë është *petka me gjyrë*. Ajo quhet *gjyripetka* ose *gjypeta me tri gurra*.

## **PETKA (GJYPETA) MBI 4000 VJEÇARE E PULTIT TË MADH ILIRO-DALMAT QË FLET SHQIP**

Një produkt etnografik është shprehje e një etnokulture të një identiteti të caktuar. Në rastin tonë ky identitet është Nikaj-Mërturi që shtrihet në territorin e Pultit të Madh prej më se 500 vjetësh, formuar nga popullsia vendase dhe dy etni të tjera që dynden njëra nga jugu i Dalmacisë dhe tjetra nga Principata e Dukagjinit, pas pushtimit turk, duke formuar një identitet kulturor origjinal si dy shtëpi në një oborr. Vendi është i banuar, të paktën, që në kohën e bronzit ku gjenden dy gradina, të paktën pesë qyteza ilire, tri prej tyre të konfirmuara, por të gjitha të pastuduara, sikurse i gjithë Veriu. Në pikun e vet, në fund të viteve '80, kishte një popullsi prej rreth 9000 banorësh, me rreth 1300 shtëpi. Nikaj-Mërturi është shtrati epik i Eposit të Kreshnikëve ku 80% e shtëpive, deri në vitet '60, kishin brenda

një lahutë. Këtu gjendej malësori që mbante 15000 vargje përmendsh. Etnokultura vendase është e ndikuar nga një klimë rritesh, dokesh e zakonesh të shtratis mitologjik iliro-pagan, nga më të fuqishmit dhe më të larmishmit, që nga kohët më të lashta, tipar i shoqërive të mbyllura gjinore që jetonin në malet e Ballkanit Perëndimor. Imagjinoni një natë feste në Nikaj-Mërtur, ku nga kullat alpine, të bien 800 lahuta përnjëherë, në një luginë midis malesh dinarike që prekin retë. Kur këndon lahuta me tingujt e dheut në emocion, ajo rrafshon malet e, mbi këtë rrafsh, ngrihet madhërishtëm miti i malësorës me kultin e amësisë, portretizuar në veshjen mitologjike që kërkon të mposhtë të ligën e të përtërijë jetën. Duke folur me gjuhën e vjetër shqipe të viteve '60, trupi i njeriut vishet me *petka*. Një produkt i tillë është *petka me gjyrë*. Ajo quhet *gjyrpetka* ose *gjypeta me tri gurra*. Petka ka idenë, formën, përmbajtjen dhe funksionin. Ne do të merremi më shumë me përmbajtjen. Petka është e përshtatshme për vendet malore me klimë të ftohtë. Forma e saj është e pashme, e virtytshme, madhështore, e përballueshme nga ekonomia familjare. *Gurrat* nga jashtë krijojnë dy nga brenda të përshtatshme për lehtësimin e lëvizjes së këmbëve në ecje nëpër rrugët malore. Dallimi me xhubletën është mungesa e ngjyrës së bardhë në fund të gjypetës dhe dekoracioni i shumtë në trupin e saj. Nga madhësia është më e mbledhur.

### **Gjuha shqipe, si gjuhë e natyrës, i jep veshjes fjalorin e saj**

Trupi i njeriut vishet me petka. Petkat e trupit, petkat e nuses, petkat e djalit etj. Fjala petkë sipas etimologëve është fjalë e trungut të shqipes. Petkat janë me gjyrë dhe pa gjyrë. Fjala gjyrë buron nga procesi i ngjyrosjes në enën prej balte, efekti i zhurmës së ujit, kur takon në sipërfaqen e enës prej balte të skuqur. Veshja e ngjyrosur quhet petkë me gjyrë ose gjyrpetka sot gjypeta. Këtu njerëzit nuk thonë po shkoj me pré një gjypetë, por me kepë (qepë) një gjypetë, mbasi qepja predominon mbi prerjen, merr kohë më shumë, ka më shumë lodhje, kërkon mjeshtri, kërkon vëmendje. Jo gjithkush mund të qepë një gjypetë. Vendosja e simboleve në gjypetë nuk quhet zbukurim, por quhet shkrim i gjypetës. Fjala "shkrim" është mesazh, është seriozitet, është fisnikëri, obligim, mision, është ndjeshmëri. Gjypeta nuk quhet e bukur, por quhet e pashme, pra, përdoret fjala pashí. Fjala e bukur duket si më e pamotivuar, më e butë, më e ftohtë, kurse pashi është më serioze, më epike, më burrërore, më dinjitoze.

Përpara, gjypeta ka paranik ose pështjellak (nga mbështjellë) në vend të fjalës 'boqe' në Shkodër, 'futë' në Tiranë, 'zapreg' në Malësi të Gjakovës. Mbrapa mbi kërdhokulla quhet mbrapanik. Në vend të fjalës *ivë* përdoret *shquell* ose *shqoj*, *shqoj të bardhë*, *shqoj të zi*, midis shqojve të gjypetës, etj. Brezi quhet ngjeshë, ngjeshë përmjetit, etj. Forma e **lugët** quhet gurrë, gurrat e gjypetës. Fjala gurrë nuk mund të zëvendësohet me fjalën lug, palë, valë, etj. Fjala gurrë është fisnikëri, është pastërti, sinqeritet, është bujari, është virtyt. Spiku quhet gajdan. Ai është detyrimisht katërkodrash d.m.th katror. Çorapë quhen shputa dhe kallmi bashkë. Kallmi është pjesa që mbulon pulpën e këmbës, deri afër kupës së gjurit, por nuk e prek atë. Gjypeta bëhet edhe me gjypnerë dhe qepet me gjylpanë. Mendoj se fjalët gjypetë, gjypnerë dhe gjylpanë kanë lidhje me njëra-tjetrën. Te kostumi me gjypetë jeleku quhet krahol, petkë që hyn ndër krahe. Krahol më mangë dhe pa mangë, me mangë të hapura.

**Petka mbi krye** (kokë) quhet **kapole**. Petka poshtë grykës quhet grykëse. Stolitë prej metali në gjoks quhen dykme nga dukme, që duken, të dukshme. Shkëlqimit i thonë *xixëllon* ose *gjigjë*, që xixëllon, që jep dritë. Në zonën etnografike të Nikaj-Mërturit kemi 5 lloje gjypetash ose 5 lloje petkash me gjyrë:

- 1) *Gjypeta e çikave;*
- 2) *Gjypeta e nuses;*
- 3) *Gjypeta e gruas ndër fëmijë;*
- 4) *Gjypeta e të moshuarave;*

## 5) Gjypeta e grave të veja.

Ato dallojnë nga njëra-tjetra më shumë nga përmbajtja sesa nga forma. Forma e gjypetës është: përpara e drejtë, kurse mbrapa e kthyer e gjerë dhe me tri gurra. Në pjesën e përparme ajo vjen e rrafshët dhe me material tjetër, me përjashtim të asaj të vajzës. Materiali përpara është më i butë për të mos fërkuar lëkurën e gjunjve, si dhe për ta bërë më të manovrueshme e më estetike. Gjypeta e vajzës mban *kodin e virgjërisë*.

### Kodi i virgjërisë

Kodi i virgjërisë gjendet vetëm te çika. Ajo, për të treguar virgjërinë e saj, kombinon shquallin e fundit të gjypetës me ngjyrë të bardhë me kallmin e çorapeve me ngjyrë të bardhë nga nyja e këmbës e lart deri në gju. Çika nuk mban shokë mesi në asnjë rast, duke ekspozuar natyralitetin e barkut të saj si e virgjër. Kostumi me gjypetë që në pamjen e parë tregon zonën etnografike të cilës i përket, statusin civil, besimin fetar, moshën, nivelin ekonomik, konceptin estetik dhe kulturën e jetesës. Çika e fejuar shaminë e kokës (rubën e kresë) e mban të lidhur nën mjekër që të mbulojë qafën dhe e rrezon atë mbi ballë për të mos u parë lehtësisht sytë e saj nga gjithkush dhe për të mbuluar hiret femërore të qafës. Kaçotën e flokëve e ka të zënë me rubë, sepse do ta rrisë atë për ta bërë bistek ditën e dasmës. Ajo gjendet gjithnjë duke punuar petka që do t'i shërbejnë për t'i dhuruar kur të bëhet nuse. Në dorën e majtë mban kosharen e lëmshit ose të punëdores.



### Gjypeta e nuses

Gjypeta e nuses shkëlqen nga të gjitha anët. Ngjyrat janë të ndezura, ngjyra feste. Varëset janë të bollshme, motivet dekorative, gjithashtu të freskëta dhe të larmishme. Gjypeta është korrekte në raport me përmasat trupore të bartësit, në harmoni me to.

Për së gjati ajo nuk duhet të bjerë më shumë se katër gisht poshtë gjurit. Gjerësia e pjesës së përparme nuk duhet të kalojë dukshëm atë të shpatullave.



### Shoka e gjypetës

Nusja ka si pjesë të pajës së saj edhe shokën e gjypetës, që është edhe shoka e fëmijës, element i pavënë re nga të gjithë studiuesit e derisotëm. Ekzistenca e saj tregon gjithë simbolikën dekorative të vendosur mbi gjypetë dhe mbi trupin e gruas ndër fëmijë. Ajo ka ekzistuar në shekuj, por nuk është vënë re nga studiuesit, mbasi nuk është kërkuar dhe koha e eksplorimit ka qenë e shkurtër. Shoka është e gjatë, aq sa të mbështjellë barkun e nënës 2-3 herë. Është me ngjyrë të kuqe, të hapur, me vija të holla të bardha, paralele në të dy anët. Ka gjerësi rreth 8cm. Është e njëjta shokë që lidh fëmijën në djep. Për të larguar syrin e keq, shokës mund t'i vihet një guackë peshku apo disa guacka. Ajo është pjesë integrale e gjypetës vetëm për gratë ndër fëmijë, siç janë edhe simbolet dekorative. Vajzat dhe gratë e veja nuk ngjeshin shokë. Ato nuk janë ndër fëmijë. Nuk mbajnë as simbolikat magjike të gjypetës së nënës ndër fëmijë. Të moshuarat mbajnë simbolikat dekorative, por jo shokë. Në Tiranë sot kemi disa gra të moshuara që e vërtetojnë këtë. Kemi një ekzemplar për ta treguar. Shoka ngjeshet në trup, katër gisht nën përmjet (brez), në kohën kur nusja kupton se është

shtatzënë. Këtu shfaqet *kulti i amësisë*. Që këtu ajo ka hyrë ndër fëmijë. Nusja bëhet grua kur hyn ndër fëmijë dhe quhet nënë e re kur lind. Shoka qëndron aty gjatë gjithë kohës që fëmija qëndron në barkun e nënës. Kjo shokë është ajo që lidh fëmijën në djep. Ekzistenca e kësaj shoke është çelësi i leximit dhe arsytimit mbi të gjithë simbolikën që mban të shkruara gjypeta në trupin e saj. Shoka, në kuptim magjik, josh fëmijën që po formohet me dashurinë që do falë jeta, me dashurinë dhe ngrohtësinë e nënës. Nëna i thotë fëmijës se të pret nëna me bekimin e perëndisë, me dashurinë e natyrës, pra, e fton jeta. Simbolikat e gjypetës, të vendosura në formë rrethore, janë ndihma që kërkon nëna nga fuqitë e natyrës e mbinatyrës për fëmijën që po formohet në barkun e saj, të largojë syrin e keq, fëmija të bëhet i bukur, i shëndetshëm, i zgjuar, i pashëm, trim, me vetitë dhe virtytet më të mira njerëzore.

Gjypeta dekorohet edhe me simbole kultesh, mitesh, simbole, simbole të shenjta në funksion të kultit të amësisë. Këtu nëna e re ka materializuar gjithë fuqinë e kultit të saj. Nëna është e lidhur aq shumë me fëmijën në kuptim magjik, sa pranon murosjen që njerëzimi të përparojë, të qëndrojnë urat dhe kalatë, por me kusht që t'i lihet një gji përjashtë për të ushqyer fëmijën e saj. Fëmija është krijesë e perëndisë.

### **Ngjyra e gjypetës**

Ngjyra e gjypetës është e zezë, por shquallin e parë nga poshtë-lart, herë-herë e ka dhe të kuqe ose kafe, por ka dhe raste kur është komplet e zezë. Gjypeta e nuses shkëlqen nga shkrimi ngjyrëndezur, nga *shqojet prej veleduni* dhe rruazat ngjyra-ngjyra. Midis tyre duken pastër e të ndezura *shqoje* të *gajdanave* të vendosur në largësi simetrike me njëra-tjetrën dhe me hapësirat midis tyre. Ka raste që është me shumë shqoje të kuqe ose dhe krejt në ngjyrë kafe të hapur me shqoje gajdani të zi. Ajo ka simbolikën e plotë mitologjike që përmban gjypeta e gruas. Ngjyra e kallmave të çorapeve është e njëjtë me atë të gjypetës. Ato quhen çorapet me kamcana, të qendisura me rruaza në një sfond prej cohe në ngjyrë të gjypetës, si dhe shputët e qendisura. Kostumi popullor ka fjalorin e vet dhe si kulturë popullore nuk pranon tjetërsime. Tek gjypeta e nuses evidentohet e materializuar gjithë fuqia mendore dhe teknike, si dhe koncepti ideoestetik i mjeshtrit popullor, që e realizon atë sipas konceptit të gjithëpranuar të komunitetit etnik që i përket. Kështu kulti i mëmësisë ka përfituar nënën e re së cilës do t'i përkushtohet gjithë jetën.

### **Gjypeta e gruas**

Gjypeta e gruas është ajo e nuses, por gradualisht, me kalimin e moshës, humbet shkëlqimin e dikurshëm dhe merr një pamje më të përmbajtur, më serioze. Ajo është prodhim artizanal, shpesh brenda ekonomisë familjare dhe nuk është një e vetme. Artizane të ndryshme prodhojnë modele të ndryshme gjypetash dhe petkash të tjera, por në përgjithësi brenda një koncepti etnokulturor të njësisë së cilës i përkasin. Nuk ka penalizime për devijime të caktuara, por vetëm thjesht nuk pëlqehet si aplikim. Çdo identitet është i arsyetuar brenda njësisë, veçanërisht në kriteret identifikuese, sipas një koncepti dhe shijeje të gjithëpranuar. Gruaja e re, si nënë e re, mban sipas dëshirës një ose dy ruba. Njëra me ngjyrë të verdhë dhe tjetra me ngjyrë të kuqe. Nuk mban rubë me ngjyrë të bardhë, sepse është grua dhe jo vajzë. Simbolika e gjypetës mund të vendoset ose përsëritet dhe në pjesë të tjera të veshjes me gjypetë në gjithë trupin e gruas ndër fëmijë, sipas dëshirës së saj. Kur nusja hyn ndër fëmijë, gjypeta e saj përfiton simbole magjike të ndryshme që lidhen me jetën, me hyjnitë, me kultin e diellit të yjeve dhe të hënës, të dritës, të ujit dhe tokës, të dragoit, etj. Ato janë përftuar ndër shekuj në mijëra vjet. Një pjesë e tyre kërkojnë specialistë të shkrimit kunjiformë apo të gjuhës së shenjave që ndoshta janë marrë të gatshme si mesazhe që vijnë nga prehistoria, por nëna i pranon për efekte magjike. Fëmija për nënën është dielli i nënës, është engjëlli i nënës, është drita e syve të nënës, i miri i nënës, i bukuri i nënës. Nëna do të përballojë jetën duke menduar fëmijën e saj. Nëna lind njeriun,

përtërin jetën. Ajo e shoqëron njeriun për në jetën e pëртеjme duke ia dorëzuar atij që e fali, fuqisë së mbinatyrshe. Gjithçka e fal Zoti dhe ato që fal Zoti janë të shenjta. Fëmijën e fton jeta dhe është nën bekimin e Zotit. Nëna e ushqen me qumështin e saj, me ngrohtësinë e shpirtit të saj, që gjithë jetën fëmija të marrë bekimin e Zotit, t'i çelë rrugën e jetës së lumtur dhe të begatë, t'i presë rreziqet dhe t'i sigurojë jetën e pëртеjme. Ajo mban simbolet e Zeusit shumer, pellazg e ilir apo dhe të hyjnive që komandojnë jetën në tokë, sipas mitologjisë së lashtë pagane, pellazgo-ilire, arbërore shqiptare. Simbolet e Zeusit krijues vihen vetëm në vendet më prestigjioze, si: në ngjeshë (rrip), në gjoks në formë varëseje, tatuazhi në dorën e majtë apo në varëse qafe.

### ***Gjypeta e grues së vejë***

Gjypeta e ***grues së vejë*** është gjysmë për gjysmë bardhezi. Ajo shoqërohet me kallma të zeza të çorapeve, sepse femra ka qenë e martuar. Edhe shqualli i fundit i gjypetës është detyrimisht i zi. Gjypeta e saj nuk ka simbolet e gjypetës së gruas së martuar ndër fëmijë. Ajo nuk është e turpëruar, por ka qenë e pafat.

### ***Gjypeta e plakave***

Gjypeta e plakave është e thjeshtë, megjithëse nuk i hiqen simbolet e trashëguara nga të qenët grua, por janë me të zbehta. Ajo nuk lind më fëmijë dhe nuk mban shokën e gjypetës, por vetëm ngjeshën (rripin) e përmjetit. Gruaja në moshë, por as plakat nuk vënë rubë me ngjyra të çelura në kokë, përveçse me ngjyrë të errët.



### ***Prerja e thekut***

Theku në këtë rast është bistek ose copë bisteku. Prerja e thekut është prerje e një pjese floku në një vend të dukshëm të kokës në atë masë sa të vihet re nga gjithkush që e sheh gruan dhe ta përçmojnë atë si të turpëruar. Kjo ndodhte në dy raste: kur ajo zihet duke vjedhur dhe kur tradhton burrin dhe zihet në flagrancë. Kur zihet në flagrancë, gjaku nuk i merret, vrasësit i paguhet plumbi. Shoqëritë e mbyllura gjinore nga fiset iliro-dalmate janë origjina e veshjes me gjypetë. Petka me gjyrë, gjypeta, është një veshje e lashtë e popullsisë të mbyllura gjinore iliro-dalmate që jetonin në malet dinarike a të Ballkanit që në periudhën e bronzit të hershëm e në vazhdimësi deri në shekullin XIX të p.e.s. Ekzistencën e jetës në Alpet e Shqipërisë e vërtetojnë edhe zbulimet arkeologjike në territorin e Pultit, në luginën e lumit të Shalës, në Theth dhe në Nikaj-Mërtur e kudo në Malësinë e Gjakovës. Petka konfirmon prezencën e saj nëpërmes etimologjisë së emrit, thjeshtësisë së elementeve të saj përbërës fillestarë, njohjes së ngjyrave nga bimët e natyrës dhe aplikimin e tyre në enët prej balte dhe në terrakota si ato të Bosnjës, shfrytëzimi i teknikës së thjeshtë të thurjes së gardhit në thurjen e copës prej leshi, në kulturën shumëshekullore të mbarështimit të bagëtive të imëta në territorin e një prej fiseve më të fuqishme të kohës, siç është Dalmacia në territorin e së cilës vazhdon të jetojë edhe sot kjo veshje.

### **PËRFUNDIME**

1. Gjypeta ka të pasqyruar në dekoracionin e saj historinë e njerëzimit, siç është periudha e etnosit ilir në dekoracionin me figura gjeometrike.
2. Shumëllojshmëria e simboleve konfirmon ekzistencën e saj mijëra vjeçare. E gjithë simbolika dekorative është në dispozicion të kultit të amësisë.

3. Dalmacia, siç prodhoi dalmatikën, shoqëritë e mbyllura malore të saj prodhuan edhe gjypetën, zhgunin dhe prodhime të tjera prej leshi. Edhe makina primitive që prodhon zhgunin, duhet të jetë dalmate, megjithëse cilësohet e emërtuar si në gjuhën serbokroate.
4. Dalmatët, të paktën 400 vjet përpara, e kishin njohur atë dhe vënë në përdorim për prodhimin e petkave prej leshi, siç është dalmatika. Gjithë pjesët e makinës primitive që prodhon zhgunin shpjegohen në gjuhën shqipe. Pse nuk është në gjuhën dalmate të zhdukur apo në gjuhën e vjetër shqipe kjo makineri? Makinaria quhet *rasboj* nga *rasë* - goditës dhe *boj* - mjaftueshëm. Pjesët e tjera janë shpata, liqtë, bërtilat dhe shulat.
5. Edhe valavicë vjen nga valë dhe vijë uji me të cilën shkelen zhgunat. Unë nuk mendoj se kjo veshje ka qenë për zonat e ngrohta apo një veshje qytetare. Pesha dhe trashësia e saj nuk e mundëson një gjë të tillë. Ajo nuk ka patur gjithnjë këtë formë.
6. Formën e pashme e fitoi me shpikjen e gajdanit, që krijoi mundësinë e të qepurit verëf. Për zonat fushore apo për veshje qytetare, mjeshtrit popullorë krijuan Dalmatikën duke treguar një nivel të dallueshëm në prodhimin e veshjeve për trupin e njeriut.
7. Ajo erdhi dhe u përmirësua me kushtet e jetesës, me fuqizimin e ndikimit mitologjik pagan ilir, grek e romak tek popullsitë me shoqëri të mbyllyra, por edhe të kulturave të tjera hitite apo egjiptiane, shumere etj.
8. Edhe sikur kjo të jetë një produkt që lidh historinë e njerëzimit, kjo nuk i heq asgjë meritës së nënave pellazgo-iliro-shqiptare që e patën për më shumë se 4000 vjet objekt dhe subjekt në shërbim të përtëritjes së jetës njerëzore mbi tokë.
9. Kjo veshje mund të ketë qenë edhe veshje mesdhetare në fillimet e veta, por e braktisur shpejt, mbasi nuk gjendet thuhet asnjë burim i besueshëm që përcakton ku dhe kur, dhe është meritë e vitalitetit mendor e shpirtëror të nënave tona që e mbajtën dhe e kultivuan këtë veshje, që sot mahnit botën dhe na e lanë trashëgim t'ua njohim me mirënjohje në jetë të jetëve atyre që e ngritën në madhësinë e madhësisë, kultin e amësisë, nënave tona pellazgo-iliro-arbërore-shqiptare.